



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD

Data 17/04/2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
TE VEÇANTA PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sistemim asfaltim i rruges Kuturman-Marinaj Njesia
Administrative Qender Bashkia Librazhd ”**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Asfalt cakell dhe rere bitumi

**VLERA E FONDIT LIMIT: 29 164 674 (njetzet e nente milion e njeqind e gjashtedhete e
kater mije e gjashteqind e shtatedhete e kater) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

- a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8,*
- b. Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;*

Argumentimi: Kriteri (a) eshte vendosur ne baze te nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

1.1 Pershtatshmeria per te kryer veprimtarine profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të për zgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojcë (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar si dhe në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të biznesit", të ndryshuar.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, ku vlera e xhiros për 3 (tre) vitet e fundit duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e fondit limit që prokurohet.**

2.1.1 Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të shoqeruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjeshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenin 43, pika 4 të VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" I ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Ligjin nr.10091 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e

kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2025 ne te gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument ne momentin e dorezimit te dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2023, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 ”Për QKB” i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 ”Për QKR”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

- **Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**

a) Kontraten e Siper marrjes,

b) Situacionin perfundimtar te objektit

c) Fatura Tatimore

d) Aktin e Kolaudimit te objektit

e) Formular Vleresimi nga Investitori sipas shtojces nr. 9

f) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- **Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

- a) Kontraten e Siper marrjes,
- b) Situacionin perfundimtar te objektit
- c) Faturat Tatimore
- d) Aktin e Kolaudimit te objektit

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenktraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Formular vlerësimi

Situacion Përfundimtar & Faturat Tatimore

Pika a) *plotesohet nga anetari i cili ka perqindjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim.*

*Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontratat e ngjashme ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. Kurse **pika b)** duhet te plotesohet nga te gjitha anetaret e bashkimit ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse te vlefshme të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP - 1 C** Punime gjurmimi në tokë;
- **NP - 4 D** Rruge autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro pista aeroportuale
- **NP - 5 C** Punime nentoksore , ura e vepra arti
- **NP - 6 B** Diga dhe tunele hidroteknike
- **NP-11 B** Ndërtime për N/stac., kab. e transform. linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- **NP-12 C** Punimet të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **NS-4 C** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik ,metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- **NS - 5 A** Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut
- **NS - 6 A** Sinjalistika Rrugore jo ndricuese
- **NS - 7 A** Barriera dhe mbrojtje rrugore
- **NS- 8 B** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
- **NS - 9 B** Punime strukturore speciale
- **NS - 10 B** Shtresa dhe mbistruktura speciale
- **NS - 13 B** Impiante dhe linje telefonike dhe telekomunikacionit
- **NS – 14 B** Impiante të brëndëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- **NS - 18B** Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, nr. 42, datë 16.01.2008 (i ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

** Per Operatorët e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

* Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t'i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.

2.3.3 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë”
- Certifikatë **ISO 45001: 2018** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë”
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”
- Çertifikatë **ISO 50001:2018** Per “Sistemin e menaxhimit te energjise”

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e vlefshme ne daten e hapjes se ofertave. Nese çertifikata eshte ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohet me perkthimin ne gjuhen shqipe te noterizuar. Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike ISO duhet plotesuar nga operatoret ekonomike, sipas natyres se puneve qe marrin persiper.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor,gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit

Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollin e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **20 (njetzet) punonjës** me kohë të plote pune për periudhën e *muajit të fundit* nga data e hapjes së ofertave, ku Stafit Teknik dhe punëtorët e kualifikuar të jenë me kohë të plote pune për periudhën e *muajit të fundit* nga data e hapjes së ofertave

Per vertetimin e këtij kushti të paraqiten:

1. Vertetim të leshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesipërme.
2. Listepagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesipërme.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, nenit 77, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik “ dhe nenit 39, Pika 6/ç, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të deshmohen që kanë fuqi minimale puntore, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor në përcaktimin e fuqisë puntore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit teknik të cmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr 216 Datë:

13.04.2023” Për Krijimin dhe Funkionimin e Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim në këtë kontekst autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përlllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit orëve të punës (8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqine puntore janë përlllogaritur punetoret e kualifikuara . Nga përlllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhen **20** punonjës me kohe te plote.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 (tre) muajt e fundit tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialiste dhe çertifikimet perkatese, si me poshte:

Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për këto punime:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- a) Inxhinier Ndërtimi (Infrastruktur Transporti) 1 (një)
- b) Inxhinier Strukturist 1 (një)
- c) Inxhinier Elektrik 1 (një)
- d) Inxhinier Gjeomatik / Topograf 1 (një)
- e) Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- f) Inxhinier Mekanik 1 (një)
- g) Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- h) Inxhinier Elektronik 1 (një)
- i) Arkitekt 1(një)

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Stafit teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

4. **2.3.6** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:
 - a) 1 (nje) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

- b) Inxhinieri Gjeomatik / Topograf I Certifikuar per Punime Kapitale Nentokesore per Infrastruktura Rrugore , dhe objekte te Tjera me karakter Publik, Certificate e lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”
- c) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.
- d) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij Drejtues Teknik (Inxhinier Ndërtimi) i certifikuar si **Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve**.
- Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve është përgjegjës për vlerësimin dhe testimin e materialeve dhe produkteve që përdoren në industrinë e ndërtimit për t’u siguruar që ato përmbushin standardet e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë. Ky lloj specialisti duhet të ketë njohuri të thella në lidhje me metodat e testimit, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe materialet që përdoren në ndërtim.
- e) 1 (një) punonjës i pajisur me certificate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”).
- f) Minimumi 1 (nje) person qe përmbush kriteret për të qene “Vlerësimi i ndikimit në mjedis” lëshuar nga Ministria e mjedisit referuar Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS

Shënim: Për kriterin si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar sipas të

cilit: “1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
	Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton-15 ton)	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës nga 8-10 ton me Vinc	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri ne 4-5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamionçine (kapaciteti mbajtës 1.5 deri ne 2 ton)	1 copë	Në pronësi ose me qera
	AutoBetoniere 2.5-3.5 m ³ mjet teknologjik me goma	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Grejder me goma mjet teknologjik me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Autobitumatrice	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Dumper (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronesi ose me qera
	Rul gome – hekur mbi 8-10 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
	Rul asfalti hekur – hekur 1- 3 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
	Rul hekur – hekur mbi 8 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
	Koke terheqese	1 cope	Pronesi ose me qera
	Rimorkiator per transportin e makinerive	1 cope	Pronesi ose me qera
	Makineri Vijezi	1 cope	Në pronësi ose me qera
	Eskavator me Zinxhir	2 cope	Në pronësi ose me qera
	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Autobetoniere	2 cope	Në pronësi ose me qera
	Autopompe betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Autovinc me Kosh	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Ekskavator me goma mjet teknologjik me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Fadromë me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Mini Eksavator me zinxhir	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Pirun Ngrites	3 copë	Në pronësi ose me qera
	Elektrosaldatrice	3 copë	Në pronësi ose me qera

	Matrapik	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Moto gjenerator	2copë	Në pronësi ose me qera
	Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Betoniere kantieri	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Depozite per Grumbullim materiale	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Tub Shkarkimi	30 ml	
	Deflektometer per shtresat e tokes	1 copë	Në pronësi ose me qera
	GPS	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Zyre Kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Instrument nivelimi (Teodolid)	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Vidator	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Troko	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Tokomak ngjeshje dheu	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Karroca	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Nivelues Betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Pompe Suvatimi	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Prerëse Pllakash	5 copë	Në pronësi ose me qera
	Përdaf Muratori	12 copë	Në pronësi ose me qera
	Pajisje P.P.E	10 copë	Në pronësi ose me qera
	Pompë Iyerje	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Vibrator Betoni	3 cope	Në pronësi ose me qera
	Pompë Uji	2copë	Në pronësi ose me qera
	Fikse Zjarri	20 copë	Në pronësi ose me qera
	Aparat Saldimi	2copë	Në pronësi ose me qera
	Aparat Testim Nyjesh	2copë	Në pronësi ose me qera
	Rrjetë Plastike	2000 m2	Në pronësi ose me qera
	Skeleri	1600 m2	Në pronësi ose me qera
	Betoforma	300 m2	Në pronësi ose me qera
	Fabrike Betoni jo me larg se 40 km (me planvendosje/genplan / certifikaten e kalibrimit) pajisur me QKL / mobile e levizeshme	1 cope	Pronesi, me qera ose aktmarveshje furnizimi
	Fabrike Asfalti jo me larg se 40 km (me planvendosje/genplan / skema teknologjike/ raportet e vetmonitorimit 6 Muaji e fundit 2026) pajisur me QKL/ mobile e levizeshme	1 cope	Pronesi, me qera ose aktmarveshje furnizimi
	Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL	1 cope	Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL

- **Pajisje të tjera ndihmëse, (të cilat duhet të vërtetohen me deklaratë sipas shtojces perkatese, të DST:**

Nr	Mjete mbrojtese	njesia	sasia	statusi
1	Kokore	copë	30	Në pronesi ose me qera

2	Jelek	copë	30	Në pronësi ose me qera
3	Tabela Sigurimi Teknik	copë	30	Në pronësi ose me qera
4	Kuti Ndhme e shpejt	copë	15	Në pronësi ose me qera
5	Prozhektor për ndricim	copë	10	Në pronësi ose me qera
6	Çizme	copë	15	Në pronësi ose me qera
7	Doreza	copë	15	Në pronësi ose me qera
8	Kominoshe	copë	15	Në pronësi ose me qera
9	Lopat	copë	12	Në pronësi ose me qera

Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie original ose fotokopje e noteruar.

- a) Makineritë dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (orgjinal ose fotokopje e noteruar).
- b) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet të mbulojë afatin e përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, foto). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar.
- d) Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklarates dhe verifikimin e makinerive dhe pajisjeve në terren. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13 pika 3 germa a të ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 i ndyshuar "për prokurimin publik".
- e) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet "Deklaratë" nga administratori i shoqërisë ofertuese. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

Argumentimi:

Ligjor: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të

përbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomik mjetet dhe pajisjet teknike Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Mjetet e mësipërme kërkohen duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

NJESIA E PROKURIMIT